



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rektori

Nr. 515 Prot.

Tiranë më 13.02 2023

URDHËR

Nr. 16, datë 13/02/2023


**PËR HAPJEN E PRANIMEVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË "GJUHË SHQIPE", NË UNIVERSITETIN "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 31.3.2021, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë", Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në Universitetin Luigj Gurakuqi, si dhe në zbatim të Urdhrit të MAS, Nr. 733, datë 12.12.2022, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Gjuhë shqipe", në Universitetin 'Luigj Gurakuqi' Shkodër,

**URDHËROJ:**

Hapjen e pranimeve në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Gjuhë shqipe", në Universitetin 'Luigj Gurakuqi' Shkodër.

Aktivizimi i programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në 'Gjuhë shqipe', në Universitetin 'Luigj Gurakuqi' Shkodër..



Aplikimet e kandidatëve për studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” në “Gjuhë shqipe” në Universitetin ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër, do të kryhen nga data 13.02.2023 deri më datë 27.03.2023.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**REKTOR**  
Prof.dr.Suzana GJEMPI





# UNIVERSITETI I SHKODRËS

## “LUIGJ GURAKUQI”

### FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Nr. 99 prot.

Shkodër, më 3. 2. 2023

#### INFORMIM PËR TË INTERESUARIT PËR APLIKIM NË PROGRAMIN E STUDIMIT DOKTORATË NË “Gjuhë shqipe”

Referuar Urdhërit të Ministrisë Arsimit dhe Sporteve nr. 733, datë 12. 12. 2022, nr. Prot. 8075/1 “Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Gjuhë shqipe” në Universitetin ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër”; bëjmë me dije se janë hapur aplikimet në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Gjuhë shqipe”, i ofruar në Universitetin e Shkodrës nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Fakulteti i Shkencave Shoqërore.

**Mënyra e zhvillimit të studimeve Doktoratë:** ndërtohet mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushën kërkimore “Gjuhë shqipe” dhe në nënfushat kërkimore të përcaktuara nga QSA dhe të miratuara me vendimin nr. 2, datë 03. 02. 2023 nga Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

**Projektet kërkimore dhe zhvillimore:** Në kuadër të programit të studimit Doktoratë në “Gjuhë shqipe” janë miratuar për financim 7 projekte kërkimore dhe zhvillimore me vendim të Senatit Akademik të USH, nr. 239, datë 22. 07. 2021 dhe me vendim të Bordit të Administrimit të USH me Vendimin nr. 345, datë 17. 11. 2021 (Lista e projekteve kërkimore - shtojca 1).

**Kohëzgjatja e studimeve dhe detyrimet:** Ky program zhvillohet me kohë të plotë pranë QSA për 3 vjet dhe me kohë të zgjatur për 5 vjet (kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar). Doktorantët që kanë përfunduar studimet në sistemin 4-vjeçar gjatë vitit të parë të studimeve të doktoraturës duhet të shlyejnë lëndët e parashikuara në programin përkatës, sipas planit doktoral të miratuar. Për studentët që kanë përfunduar studimet në programet e studimit të degëve të përafërta caktohen edhe disa lëndë shtesë sipas përcaktimeve të QSA-së dhe të departamentit të Gjuhësisë.

**Kriteret e pranimit dhe dokumentacioni përkatës:** Miratuar me vendimin nr. 1, datë 03. 02. 2023 të Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor” pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore “Mbi miratimin e kriterëve të pranimit në programin e studimit Doktoratë në ‘Gjuhë shqipe’”.



**Personeli akademik i kategorisë 'Profesor'-udhëheqës shkencor për doktorantët:**  
Bazuar në shkresën e MAS nr. 286/l prot., datë 24. 01.2023 (Lista e personelit akademik të kategorisë 'Profesor' në mbështetje të programit të studimit të ciklit të tretë Doktoraturë në "Gjuhë shqipe" - shtojca 2).

**Numri i kuotave për këtë program studimi:** 9 (nëntë) doktorantë.

**Modeli i projekt-propozimit të kërkimit shkencor për doktorantin** (*Modeli i paraqitjes së projekt-propozimit kërkimor të kandidatit për doktoraturë - shtojca 3*).

**Formularët për t'u plotësuar e dorëzuar:** Formularin e aplikimit për programin e studimit 'Dokoratë' në "Gjuhë shqipe", Formularin e Vetëdeklarimit të kandidatit për zbatimin e standarteve shkencore dhe etike në programin e studimit Doktoratë; dhe Formularin e Deklaratës vetjake të kandidatit për përballimin e shpenzimeve në programin e studimit Doktoratë i gjeni pranë sekretares së Qendrës së Studimeve Albanologjike.

**Afati i aplikimeve dhe i pranimit të dokumentacionit:** 13. 02. 2023 deri 13. 03. 2023.

**Vendi i pranimit të dokumentacionit:** Dorëzimi i dosjes së aplikimit me dokumentacionin e duhur bëhet pranë sekretares së Qendrës së Studimeve Albanologjike. Aplikimet pranohen çdo ditë pune në orarin 09<sup>00</sup> - 14<sup>00</sup>.

**Procedura e përzgjedhjes së aplikantëve si studentë Doktorate:** fillon pas përfundimit të afatit të aplikimeve. Ajo zhvillohet në përputhje me Rregulloren e programit të studimit Doktoratë në "Gjuhë shqipe" dhe me kriteret e miratuara nga USH.

**Tarifa e regjistrimit** është 3 000 lekë.

**Tarifa vjetore e shkollimit për studimet në Doktoratë** është 300 000 lekë në total ose 100 000 lekë në vit (Bazuar në vendimin e Bordit të Administrimit të USH nr. 153 datë 23. 04. 2021).

Për informacione më të detajuara mund të drejtoheni pranë Drejtueses së Qendrës së Studimeve Albanologjike.





# UNIVERSITETI I SHKODRËS

## “LUIGJ GURAKUQI”

### FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Nr. 98 prot.

Shkodër, më 3. 2. 2023

#### V E N D I M

Nr. 2, datë 3. 2. 2023

### “MBI MIRATIMIN E FUSHËS DHE NËNFUSHAVE TË KËRKIMIT SHKENCOR NË PROGRAMIN DOKTORATË NË ‘GJUHË SHQIPE’”

Nisur nga propozimi i Qendrës së Studimeve Albanologjike, në mbështetje të vendimit të Senatit akademik të USH nr. 238, datë 22. 07. 2021 dhe të Bordit të Administrimit nr. 345, datë 17. 11. 2021 “Për miratimin e projekteve të doktoraturave”, Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në mbledhjen e sotme të datës 03. 03. 2023.

#### v e n d o s i :

- I. Të miratohet fusha dhe nënfushat e kërkimit shkencor në doktoratën “Gjuhë shqipe”, si më poshtë :
  - A. Fushë kryesore kërkimi shkencor:  
**GJUHË SHQIPE** (“Gjuha e shkruar e autorëve të trevës së Veriut”).
  - B. Nënfushat e kërkimit shkencor :
    1. **Studimi i gjuhës së autorëve të traditës:**
      - Preng Doçi (1846 – 1917),
      - Filip Shiroka (1859 – 1935),
      - Anton Xanoni (1863 – 1911),
      - Ndoc Nikaj (1864 – 1945),
      - Ndre Mjeda (1866 – 1937),
      - Gjergj Fishta (1871 – 1940),
      - Mati Logoreci (1867 – 1941),
      - Bernardin Palaj (1894 – 1947),
      - Shtjefën Gjeçovi (1874 – 1927),
      - Luigj Gurakuqi (1879 – 1925),
      - Hilë Mosi (1885 – 1933),



- Vinçenc Prendushi (1885 - 1949),
  - Anton Harapi (1888 - 1940),
  - Donat Kurti (1903 - 1983),
  - Lazer Shantoja (1892 - 1945),
  - Justin Rrota (1889 - 1964),
  - Karl Gurakuqi (1895 - 1965),
  - Ethem Haxhiademi (1902 - 1965),
  - Ernest Koliqi (1903 - 1975),
  - Migjeni (1911 - 1937),
  - Risto Siliqi (1882 - 1936),
  - Gaspër Pali (1916 - 1942),
  - Qemal Draçini (1922 - 1947),
  - Haki Stermilli (1895 - 1953),
  - Martin Camaj (1925 - 1992),
  - Arshi Pipaj (1920 - 1997),
  - Injac Zamputi, (1910 - 1998),
  - Azem Shkreli (1938 - 1997)
  - Autorë arbëreshë etj..
2. *Gjurmimi, riprodhimi dhe studimi i gramatikave të shqipes të hartuara në shek. XVIII - XIX, si gramatika e :*
- F. M. Da Lecces (1716),
  - W. M. Likut (1814),
  - Sh. Shkodrës (1850),
  - J. De Radës (1894),
  - O. Dozonit (1879),
  - G. Majerit,
  - H. Pedersenit (1895),
  - F. Rosit (1866),
  - G. Jungut (1880),
  - J. Piskos (1896),
  - V. Librandit (1897),
  - S. Frashërit (1886),
  - P. Vasës (1887),
  - G. Benusit (1890, 1897),
  - D. Kolecit (1901) etj..
3. *Studime gjuhësore dhe leksikografike të traditës. Do të studiohet vepra gjuhësore dhe leksikografike e autorëve :*
- Nikollë Gazulli
  - Ali Ulqinaku.



- Justin Rrota,
- Mati Logoreci,
- Mustafa Kruja,
- Jak Jungu
- Gjergj Fishta,
- Ndre Mjeda
- Ndoc Nikaj etj..

4. *Vjelje dhe studim i materialit leksikor përmes botimeve*

- Vjelja dhe studimi i fjalësit në të gjitha rrafshet gjuhësore në shërbim të pasurimit të leksikut të shqipes.
- Vjelja dhe studimi tabuve, eufemizmave dhe i të gjitha materialeve me vlerë etnolinguistike të shqipes, si pasuri e veçantë e leksikut të shqipes.
- Vjelja dhe studimi i frazeologjisë shqipe.





## Shtojca – 1

# PROJEKTET KËRKIMORE-SHKENCORE DHE TË ZHVILLIMIT PËR DOKTORATËN “Gjuhë shqipe”

Me vendimin e Senatit akademik të USH nr. 238, datë 22. 07. 2021 dhe të Bordit të Administrimit nr. 345, datë 17. 11. 2021 “Për miratimin e projekteve të doktoraturave”, janë miratuar këto projekte shkencore :

1. Fjalor historik i gjuhës shqipe (shek XVI-XIX);
2. Gramatikat e shqipes të shek. XVIII – XIX;
3. Ndhimesa të autorëve shqiptarë në mërgim për zhvillimin e gjuhës shqipe në rrafshet e ndryshme gjuhësore;
4. Dom Ndoc Nikaj - Rilindasi i fundit (Veçori gjuhësore);
5. Leksiku në epikën e atë Gjergj Fishtës” (“Lahuta e malcís”, “Mojs Golemi”);
6. Leksikografi me alfabetin e autorëve të veriut”;
7. Fjalorët e shqipes të shek XIX-XX.





Shtojcë – 2

**LISTA E PERSONELIT AKADEMIK TË KATEGORISË ‘PROFESOR’ NË  
MBËSHTETJE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË  
DOKTORATURË NË “Gjuhë shqipe”**

Mbështetur në shkresën nr. 286/1, datë 24. 01. 2023 të Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve “Mbi listën e udhëheqësve në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Gjuhë shqipe” për vitin akademik 2022 – 2023”, personeli akademik që do të udhëheqë doktoraturat në “Gjuhë shqipe” do të jetë :

<b>Nr.</b>	<b>Emri/Mbiemri</b>	<b>Titulli shkencor</b>
1.	Artan HAXHI	Profesor.
2.	Mimoza PRIKU	Profesor
3.	Orjeta BAJA	Profesor i asociuar
4.	Rezarta DRAÇINI	Profesor i asociuar
5.	Francesko ALTIMARI	Profesor
6.	Matteo MANDALA	Profesor
7.	Shezai RROKAJ	Profesor
8.	Edlira BUSHATI	Profesor i asociuar
9.	Eljana LAÇEJ	Profesor i asociuar



(Shtojca 3)

**MODELI I PARAQITJES SË PROJEKT-PROPOZIMIT KËRKIMOR TË  
KANDIDATIT PËR DOKTORATURË NË "Gjuhë shqipe"**

1. Nënfisha e përzgjedhur e kërkimit (nga nënfushat e miratuara të kërkimit në aplikimin e programit të Doktoraturës).
2. Udhëheqësi shkencor i propozuar (nga lista e pedagogëve të kategorisë 'Profesor' si mbështetës të programit të Doktoraturës me udhëheqje shkencore të studentëve doktorantë).
3. Përshkrimi i situatës aktuale (përshkrim i situatës aktuale të fushës kërkimore, konteksti dhe hapësira e zhvillimit të kërkimit dhe arsyetimi që justifikon nevojën e ndërmarrjes së këtij projekt-propozimi kërkimor - deri 500 fjalë); qëllimi dhe objektivat e kërkimit (evidentim i qartë i pyetjes/pyetjeve kërkimore, i qëllimit të kërkimit dhe listimi i objektivave kërkimore).
4. Rezultatet dhe risitë e pritshme të projekt-propozimit (rezultatet e pritshme të lidhura me objektivat e kërkimit, risitë dhe kontributi akademik dhe praktik i pritshëm i studimit kërkimor).
5. Metodologjia e kërkimit të projekt propozimit (Përshkrim i metodologjisë së kërkimit shkencor).
6. Bibliografia dhe web-bibliografia.



# UNIVERSITETI I SHKODRËS

## “LUIGJ GURAKUQI”

### FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

Nr. 97 prot.

Shkodër, më 3. 2. 2023

#### V E N D I M

Nr. 1, datë 3. 2. 2023

#### “MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMIN DOKTORATË NË ‘GJUHË SHQIPE’”

Nisur nga propozimi i Qendrës së Studimeve Albanologjike, dalë nga mbledhja e datës 02. 02. 2023 dhe në mbështetje të:

- Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr. 112, datë 23. 02. 2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’”, i ndryshuar me VKM nr. 808 datë 11. 12. 2019;
- VKM nr.777, datë 26. 12. 2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 75, datë 12. 02. 2018, “Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”;
- Udhëzimit të MASR nr. 52, datë 03. 12. 2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, ndryshuar me Udhëzimin e MASR nr.20, datë 22. 09. 2017;
- Udhëzimit të MASR nr. 1, datë 14. 01. 2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.7, datë 31. 03. 2021;
- Udhëzimit të MASR nr.16, datë 08. 07. 2019, “Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”;
- Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20. 09. 2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”;
- Udhëzimit të MASR nr. 29, datë 18. 12. 2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërore të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”;




- Urdhërit të MAS nr. 733, datë 12. 12. 2022, nr. Prot. 8075/1 “Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Gjuhë shqipe” në Universitetin ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër”;
- Statutit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”;
- Rregullores së Doktoraturës në “Gjuhë shqipe”;

Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në mbledhjen e sotme të datës 03. 02. 2023,

#### v e n d o s i :

1. Të miratohen kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t’u përfshirë në programin e studimit Doktoratë në “Gjuhë shqipe”, si më poshtë:
  - a. të ketë përfunduar studimet e larta në profilin Gjuhë-Letërsi ose Gjuhë e huaj.
  - b. të zotërojë të paktën njërën nga ndiplomat ‘Master i Shkencave’, ‘Master i Arteve’, ‘Diplomë e integruar e Nivelit të Dytë’, ‘Diplomë e Nivelit të Dytë’, ‘Diplomë Master Ekzekutiv’, Diplomë e lëshuar në Republikën e Shqipërisë për programin e studimit që ka zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, apo diplomë nga një program studimi të barasvlefshëm të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga Ministria e Arsimit në Shqipëri;
  - c. të ketë notë mesatare në studimet e ciklit të parë jo më pak se 8.00; notë mesatare në studimet e ciklit të dytë të studimeve jo më pak se 8.00 ose të ketë fituar jo më pak se 80% të pikëve totale nga vlerësimi përkatës për studimet e kryera jashtë vendit;
  - d. të njohë në nivelin C1 një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
  - e. të ketë dy rekomandime prej personelit me titull akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
  - f. të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike në programin e studimeve.
2. Nga kandidatët që plotësojnë kriteret prioritet ka :
  - a. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në Departamentin e Gjuhësisë ose QSA-së, të Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës;
  - b. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në Fakultetin e Gjuhëve të huaja të Universitetit të Shkodrës;
  - c. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në departamentet e Gjuhës shqipe të universiteteve të tjera publike apo jopublike;

- 
- d. Personeli akademik i punësuar me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës;
  - e. Personeli akademik i punësuar me kohë të pjesshme në Fakultetin e Gjuhëve të huaja të Universitetit të Shkodrës;
  - f. Punonjës të administratës, bibliotekave, institucioneve dhe organizatave publike apo jopublike, që përfshihen në kërkim bazë ose të zbatuar, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të Doktoraturës.
3. Dosja me dokumentacionin për aplikim në programin e studimit Doktoratë në “Gjuhë shqipe” duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme :
- a. Curriculum Vitae me foto personale;
  - b. Letër motivimi;
  - c. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës dhe dy fotografi;
  - d. Kopje e noterizuar e diplomave dhe e listës së notave të studimeve ose certifikata të njehsimit të tyre nga Ministria e Arsimit në Shqipëri (në rastin kur aplikanti i ka kryer studimet jashtë territorit të Shqipërisë);
  - e. Dëshmi e gjuhës së huaj e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare (kopje e noterizuar) që vërteton plotësimin e kriterit për gjuhën e huaj (niveli C1);
  - f. Dy rekomandime prej personelit me titull akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
  - g. Vërtetim nga qendra e punës;
  - h. Propozimi i kandidatit për kërkimin shkencor që do të zhvillojë në përputhje me projektet kërkimore dhe/ose fushat e nënfushat kërkimore të miratuara për këtë program studimi;
  - i. Deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin;
  - j. Vetëdeklarim i kandidatit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike të kërkimit shkencor e të publikimit;
  - k. Deklaratë vetjake e kandidatit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës;
  - l. Mandat pagese për tarifën e aplikimit në ALL.
4. Dorëzimi i dosjes së aplikimit me dokumentacionin e duhur bëhet pranë sekretares së Qendrës së Studimeve Albanologjike, duke mbajtur procesverbal për dokumentacionin e dorëzuar. Aplikimet pranohen çdo ditë pune në orarin e shpallur në thirrjen për aplikim. Dosjet përcillen për miratim përfundimtar në Rektoratin e Universitetit të Shkodrës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari  
Prof. dr. Ardan FAXHI

